



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.86**

**23 qershor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MF dhe MPPT nr.9293/1, datë 8.6.2011	Për përcaktimin e tarifës për kartën e memories së tahografit digjital ..... 3579
Vendim i GJK nr.24, datë 9.6.2011	Me objekt interpretimin përfundimtar të nenit 125, pikat 1 dhe 2; të nenit 136, pikat 1 dhe 5 (vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë); të nenit 125, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë..... 3580
Vendim i GJK nr.25, datë 10.6.2011	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.615, datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë..... 3592
Vendim i GJK nr.26, datë 13.6.2011	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.00-2009-406 (681), datë 4.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr.254, datë 19.12.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër; Shfuqizimi i vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Interpretimi i nenit 146/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe i nenit 433/2 të Kodit të Procedurës Penale; Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “nga mbrojtësit”, të nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale..... 3599
Vendim i GJK nr.27, datë 14.6.2011	Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, i vendimit nr.138, datë 1.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dajt”; Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Ministrave. 3606

**UDHËZIM**  
**Nr.9293/1, datë 8.6.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR KARTËN E MEMORIES SË TAHOGRAFIT DIGJITAL**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.10 211, datë 23.12.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.9, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahogرافit digjital në Shqipëri”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave

**UDHËZOJNË:**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Kartat e memories së tahogرافit digjital lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për drejtuesit e mjeteve, të përfshirë në ligjin nr.9514, datë 18.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr.4 të saj” dhe, ose të përfshirë në rregulloren “Për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

**Neni 2**

**Tarifat e lëshimit të kartave të memories për tahogرافin digjital**

1. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për drejtuesit e mjetit të përmendur në pikën 1 të nenit 1, është në shumën 100 euro.
2. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për kompanitë e transportit rrugor dhe ofiçinave të tahogرافit është në shumën 100 euro.
3. Karta e tahogرافit digjital për personat e kontrollit dhe/ose grupet e kontrollit lëshohet pa pagesë.
4. Tarifa për rinovimin, zëvendësimin dhe ndryshimin e kartës së tahogرافit digjital, të përmendura në pikat 1 dhe 2, është e njëjtë me tarifën e lëshimit për herë të parë.
5. Rinovimi, zëvendësimi dhe ndryshimi i kartës së tahogرافit digjital, të përmendura në pikën 3 kryhet pa pagesë.

**Neni 3**

Në tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim është e përfshirë TVSH-ja.  
Udhëzimi hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE**  
**DHE TRANSPORTIT**  
**Sokol Olldashi**

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**

**VENDIM**  
**Nr.24, datë 9.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Pilloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 21.12.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.37/22 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga deputeti Viktor Gumi.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Presidenti i Republikës, në mungesë.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Jonida Dervishi, me autorizim.

**OBJEKTI:** Interpretimi përfundimtar i nenit 125, pikat 1 dhe 2; i nenit 136, pikat 1 dhe 5 (vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë); i nenit 125, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 124 e 134, pika 1, shkronja “c” të Kushtetutës; neni 27 dhe vijues dhe neni 71 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Altina Xhoxhaj; përfaqësuesin e kërkuarit; përfaqësuesit e subjektit të interesuar (Kuvendi i Republikës së Shqipërisë) dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Në muajin shtator 2010 Presidenti i Republikës (Presidenti) ka emëruar me dekret katër anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe tre anëtarë të Gjykatës së Lartë. Këto dekrete i janë dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) për dhënien e pëlqimit, në mbështetje të neneve 125/1 dhe 136/1 të Kushtetutës.

2. Kuvendi ka pezulluar procedurat për votimin (dhënien e pëlqimit) për dekretet e mësipërme të Presidentit, pasi një grup deputetësh (kërkuarit), që përbëjnë një të pestën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 134/1/c të Kushtetutës, me kërkesë për interpretimin përfundimtar të nenit 125, pikat 1 dhe 2, të nenit 136, pikat 1 dhe 5 (vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë) dhe të nenit 125, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Kërkuarit pretendojnë se interpretimi i këtyre dispozitave kushtetuese është i nevojshëm për sqarimin e çështjeve që kanë të bëjnë me:

3.1 kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë;

3.2 përcaktimin nëse ka konflikt kushtetues në rastin e parashikimit të kritereve të njëjta për gjyqtarët e këtyre dy gjykatave;

3.3 përcaktimin nëse duhet të ketë ndonjë raport në përbërjen e Gjykatës së Lartë mes gjyqtarëve që vijnë nga pushteti gjyqësor dhe juristëve që kanë përvojë jashtë këtij sistemi;

3.4 përcaktimin nëse kandidatura për gjyqtar të Gjykatës së Lartë duhet t'i plotësojë kriteret në momentin e dekretimit nga Presidenti apo në momentin e shqyrtimit të dekretit përkatës në Kuvend;

3.5 përcaktimin e një mekanizmi të vlefshëm, me qëllim respektimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, për përtëritjen e Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet me një të tretën e anëtarësisë së saj.

Kërkuesit, në mënyrë të përmbledhur, kanë parashtruar këto argumente në mbështetje të kërkesës:

- Procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë duhet të jetë transparente dhe të ofrojë mekanizma mbrojtës ndaj emërimeve të motivuara mbi konsiderata politike ose të pasakta.

- Dekreti i Presidentit, duhet të jetë i arsytuar dhe, për përzgjedhjen e kandidaturave, Presidenti duhet të marrë vlerësimin e punëdhënësve të kandidatit dhe, ku është e mundur, të kërkohet mendim me shkrim edhe nga organe të tilla, si: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Inspektorati i Lartë për Deklarimin e Pasurive, Dhoma Kombëtare e Avokatisë etj.

- Gjykata e Lartë është shkalla më e lartë gjyqësore për gjyqtarët e karrierës, çka do të thotë që në përbërje të saj shumica duhet t'i përkasë gjyqësorit. Qenia 10 vjet gjyqtar ose 15 vjet jurist i shquar, për anëtarësinë në Gjykatën e Lartë, dhe jurist me kualifikim të lartë dhe 15 vjet përvojë, për Gjykatën Kushtetuese, nuk e bën kandidaturën automatikisht të aftë për të konkurruar dhe për të qenë anëtar i këtyre dy trupave gjyqësorë.

- Neni 125/3 i Kushtetutës sanksionon se përbërja e Gjykatës Kushtetuese duhet të reflektojë përtëritje çdo tre vjet me një tretën e anëtarësisë së saj. Aktualisht ka mbaruar mandati i gjashtë gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Në këto kushte lind si domosdoshmëri ballafaqimi i situatës aktuale me përcaktimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, nëpërmjet një vendimi interpretues përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

4. Subjekti i interesuar, Presidenti, me shkresën nr.2032/1 prot., datë 26.11.2010, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, shprehet se kompetencat për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë janë ushtruar sipas attributeve që Kushtetuta ka parashikuar për Presidentin. Në këtë drejtim, deri në dhënien ose jo të pëlqimit për këto dekrete nga ana e Kuvendit, Presidenti e vlerëson të përmbushur funksionin e tij kushtetues për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.

5. Subjekti i interesuar, Kuvendi, parashtrroi në mënyrë të përmbledhur:

i) Në lidhje me kriteret që duhet të përmbushë gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, neni 125/2 i Kushtetutës është i qartë dhe nuk lë hapësira për interpretime për dy nga kriteret ("profesionin jurist" dhe "përvojën jo më pak se 15 vjet në profesion"), por është më i gjerë në lidhje me kriterin tjetër mbi "kualifikimin e lartë".

ii) Për kategorinë e "juristëve të shquar" duket se kriteret e përcaktuara nga ligji për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë janë pothuajse të njëjta me ato të parashikuara për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, edhe pse këto dy organe janë të ndryshme, si për sa i përket juridiksionit, ashtu dhe kompetencave.

iii) Për Gjykatën e Lartë ligji nuk shprehet për raportin numerik midis gjyqtarëve me 10 vjet vjetërsi dhe juristëve me 15 vjet përvojë.

iv) Kuvendi, në ushtrimin e kompetencës së tij për vlerësimin e meritës së kandidaturave, ka mundësinë dhe të drejtën e përcaktimit të kritereve mbi të cilat mbështet pëlqimin e tij, duke përcaktuar, gjithashtu, peshën dhe vlerën që i jep secilit kriter.

v) Në situatën aktuale, kur ka përfunduar mandati i gjashtë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, lind nevoja e përcaktimit të një mekanizmi të vlefshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës.

## II

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson të shprehet paraprakisht për juridiksionin e saj për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, pavarësisht se një pretendim i tillë nuk është parashtruar nga palët në këtë gjykim kushtetues.

7. Bazuar në nenin 124 të Kushtetutës, Gjykata garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj, çka përbën funksionin bazë të këtij organi. Kjo kompetencë e Gjykatës gjen pasqyrim edhe në nenin 71 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon, ndër të tjera, kategoritë e subjekteve që legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës, elementet që duhet të plotësojë kërkesa për interpretim dhe subjektet pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues.

8. Interpretimi i ligjit themelor të shtetit është funksioni kryesor i kësaj Gjykate dhe ajo e ushtron këtë kompetencë sa herë që vihet në lëvizje për t’u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese, sepse gjatë këtij kontrolli është i nevojshëm, në çdo rast, interpretimi i kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim.

9. Gjykata, për t’u shprehur për interpretimin e normës kushtetuese, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, kërkon plotësimin e disa kushteve.

9.1 Së pari, kërkohet ekzistenca e një marrëdhënieje të ngushtë ndërmjet fakteve dhe normës konkrete. Gjykata mund dhe duhet të investohet vetëm nëse interpretimi që i kërkohet është i lidhur me një mosmarrëveshje konkrete, që ka lindur si pasojë e zbatimit ose kuptimit të ndryshëm/gabuar të normës kushtetuese. Ajo bën interpretimin e normës kushtetuese vetëm nëse vlerëson se gjendet para një “problemi kushtetues” dhe synon zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Nëse do të pranohet një interpretim *ad contrario*, Gjykata do të gjendej para një situatë ku produkt i interpretimit do të ishin opinione për mënyrën se si duhet të sillen, në të ardhmen, institucionet shtetërore ose do të përfundonte duke ushtruar një kontroll *ex ante* të veprimtarisë së këtyre institucioneve, pa pasur një mosmarrëveshje konkrete.

9.2 Së dyti, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar, pasi kjo krijon mundësinë e mënjanimit të mosmarrëveshjeve ose paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre (shih vendimet nr.75, datë 19.4.2002; nr.18, datë 14.5.2003; nr.2, datë 19.1.2005; nr.29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

9.3 Së treti, Gjykata e ushtron këtë kompetencë nëse vlerëson se problemi kushtetues ka ardhur si pasojë e paqartësive në zbatimin e normës kushtetuese dhe jo nëse për zgjidhjen e tij nevojitet ndryshimi i ligjeve të zakonshme, sepse në të kundërt ajo do të merrte kompetencat e organeve të tjera, në këtë rast të organit ligjvënës.

10. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese dhe të rrethanave të çështjes, Gjykata vlerëson nëse plotësohen kushtet që ajo të investohet për dhënien e një interpretimi të normave kushtetuese, objekt i kërkesës.

11. Gjykata vëren se në Kuvend janë paraqitur për miratim disa dekrete të Presidentit për emërimin e gjyqtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë që Presidenti e ka konsideruar të përmbushur funksionin e tij kushtetues për emërimin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave, Kuvendi ka vlerësuar se normat kushtetuese, që gjejnë zbatim në këtë procedurë, nuk janë të qarta dhe lënë vend për interpretim, dhe ka vendosur pezullimin e procedurës për votimin e këtyre dekreteve. Si pasojë, ka lindur një mosmarrëveshje konkrete që konkretizohet me interpretimin e ndryshëm që u jepet normave kushtetuese nga këto dy organe.

12. Gjykata vëren, gjithashtu, se secili prej këtyre organeve, që janë zbatuesit e normave kushtetuese objekt interpretimi, e ka shprehur qëndrimin e tij, përkatësisht Presidenti duke nxjerrë dekrete dhe duke i dërguar ato në Kuvend dhe ky i fundit, duke pezulluar procedurat dhe duke e dërguar çështjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

B. Për interpretimin e nenit 125, pika 2 dhe nenit 136, pika 5 të Kushtetutës (vetëm për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë)

13. Kërkesit kanë kërkuar para Gjykatës interpretimin e dispozitave kushtetuese që përcaktojnë kriteret për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë.

14. Gjykata vëren se, bazuar në nenin 125/2 të Kushtetutës, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen nga radhët e juristëve me kualifikim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet në profesion, ndërsa për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, neni 136/5 i Kushtetutës ka parashikuar se gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë me arsim të lartë juridik. Për procedurat e zgjedhjes dhe kriteret e tjera që duhet të plotësojnë kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, norma kushtetuese parashikon përcaktimin e tyre me ligj. Po ashtu, kjo normë nuk parashikon as ndonjë ndarje/raport numerik në përbërjen e Gjykatës së Lartë, mes kandidaturave që vijnë nga gjyqësori dhe atyre jashtë tij.

15. Gjykata vëren se për parashikimin e nenit 136/5 të Kushtetutës, kërkesit nuk pretendojnë paqartësi në zbatimin e normës kushtetuese, por ngrenë pretendime, në thelb, për interpretimin e nenit 3 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, sipas të cilit gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga radhët e gjyqtarëve me vjetërsi jo më pak se 10 vjet ose nga radhët e juristëve të shquar, që e kanë ushtruar këtë profesion jo më pak se 15 vjet.

16. Gjykata rithekson se, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës dhe në zbatim të kriterëve e standardeve të përmendura më sipër, ajo investohet në rast se problemi kushtetues ka ardhur si pasojë e paqartësisë në zbatimin e normës kushtetuese dhe jo si pasojë e paqartësive në zbatimin e normës ligjore. Norma ligjore mund të jetë objekt i kontrollit kushtetues vetëm nëse Gjykata do të investohej në bazë të nenit 131/a të Kushtetutës, me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë së kësaj norme me Kushtetutën. Në këto kushte, interpretimi i kriterëve ligjore për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

17. Kërkesit kërkojnë, në kuptim të po kësaj norme kushtetuese (neni 136/5), edhe interpretim për faktin nëse duhet të ketë ndonjë raport në përbërjen e Gjykatës së Lartë mes gjyqtarëve që vijnë nga pushteti gjyqësor dhe juristëve që kanë përvojë jashtë sistemit gjyqësor; nëse karriera vertikale nga gjykata e apelit në Gjykatën e Lartë duhet të jetë element fundor i karrierës në gjyqësor; nëse një kandidaturë për gjyqtar në Gjykatën e Lartë duhet të plotësojë kriterin 10 vjet gjyqtar në momentin e dekretimit nga Presidenti apo në momentin e shqyrtimit të dekretit në Kuvend; nëse mund të shtojë Kuvendi kriteret e tjera shtesë etj.

18. Gjykata vëren se funksioni më i rëndësishëm i pushtetit ligjvënës, në një shtet të së drejtës, është nxjerrja e ligjeve dhe është në kompetencë vetëm të Kuvendit që, nëse vlerëson se dispozita të ndryshme kanë nevojë për ndryshime ose plotësime, të ushtrojë funksionin e tij për miratimin e rregullimeve përkatëse. Në kushtet kur në Kushtetutë, ose edhe në ligjet e tjera, elementet e mësipërme të parashtruara nga kërkesit, nuk gjejnë rregullim të hollësishëm, këto elemente nuk mund të plotësohen nëpërmjet vendimit interpretues të Gjykatës. Interpretimi ka për qëllim t'i japë normës kushtetuese kuptimin e drejtë të saj dhe nuk ka për qëllim plotësimin e boshllëqeve kushtetuese/ligjore, sepse përndryshe Gjykata do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se interpretimi i nenit 136, pika 5 të Kushtetutës nuk hyn në juridiksionin kushtetues.

19. Për parashikimin e nenit 125, pika 2 të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkesi ka kërkuar interpretimin e kriterit “kualifikim i lartë” që duhet të plotësojë një kandidat për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

20. Gjykata vëren se në procedurën për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përfshihen dy organe të përcaktuara shprehimisht në Kushtetutë: Presidenti, i cili shqyrton kandidaturat, dekreton kandidatët e përzgjedhur dhe i paraqet ato për miratim, dhe Kuvendi, i cili merr vendimin për dhënien ose jo të pëlqimit për kandidaturat përkatëse të përzgjedhura nga Presidenti.

21. Në këndvështrimin e Gjykatës kualifikimi i gjyqtarëve është së pari një vlerësim krateresh dhe vlerash i bërë nga Presidenti dhe më pas edhe nga Kuvendi. Është mision dhe përgjegjësi e Presidentit që mes kandidaturave, që plotësojnë kriteret kushtetuese/ligjore, të bëjë përzgjedhjet që ai mendon se janë më të përshtatshme dhe që paraqesin vlera për të ushtruar funksionin e një gjyqtari kushtetues. Pas përzgjedhjes së bërë nga Presidenti, Kuvendi ka, gjithashtu, kompetencën ekskluzive të vlerësojë faktet e paraqitura, me qëllim të vlerësimit jo vetëm të plotësimit të kushteve formale, por edhe të meritës së kandidaturës përkatëse.

22. Ky sistem emërimi, i pranuar nga Kushtetuta, i vendos subjektet që përfshihen në të, para kërkesës së respektimit të parimit të luajalitetit kushtetues, i cili, në thelb, shpreh respektin e ndërsjellë nga secili subjekt ndaj kompetencave të tjetrit, si dhe nënkupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre (shih vendimin nr.2, datë 19.1.2005 të Gjykatës Kushtetuese).

23. Gjykata vlerëson se Presidenti dhe Kuvendi, gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre kushtetuese, janë interpretuesit e parë të normës kushtetuese dhe përcaktimi, nga ana e Gjykatës, i kriterëve që duhet të plotësojë një kandidaturë, çon në marrjen, nga kjo e fundit, të kompetencës kushtetuese të secilit prej këtyre organeve. Në këtë kuptim, Presidenti dhe Kuvendi, bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kriterëve ligjore, në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, në funksion të sigurimit të një përbërjeje cilësore të Gjykatës Kushtetuese.

C. Për interpretimin e nenit 125, pika 1 dhe nenit 136, pika 1 të Kushtetutës

24. Gjykata vëren se për përmbajtjen e neneve 125/1 dhe 136/1 të Kushtetutës, të cilat parashikojnë se gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti me pëlqimin e Kuvendit, ajo është shprehur në vendimin e saj nr.2, datë 19.1.2005, e vënë në lëvizje me kërkesë të Presidentit.

25. Në këto kushte, për këtë pjesë të kërkesës, Gjykata rikonfirmon qëndrimin e saj se pëlqimi, që kërkojnë normat e mësipërme kushtetuese, nënkupton një lloj konsensusi midis dy organeve kushtetuese që përfshihen në procesin e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë. Pjesëmarrja e Kuvendit në këtë proces ka për qëllim balancimin e kompetencës së Presidentit në emërimin e gjyqtarëve dhe kjo vjen në harmoni edhe me parimin e ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, të parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës. Në këtë vështrim, pjesëmarrja e Kuvendit në procesin e emërimit të gjyqtarëve, që shkon tej një kontrolli juridik të procesit, është në harmoni të plotë me natyrën politike të këtij organi.

Ç. Për interpretimin e nenit 125, pika 3 të Kushtetutës

26. Kërkuessit kanë kërkuar, gjithashtu, interpretimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, sipas të cilit “Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo tre vjet në një të tretën e saj sipas procedurës së caktuar me ligj”. Kërkuessit pretendojnë se, në raport me situatën aktuale të përfundimit të mandatit të gjashtë gjyqtarëve të Gjykatës, ka lindur nevoja e përcaktimit të një mekanizmi të vlefshëm, me qëllim respektimin e parashikimit kushtetues të nenit 125/3.

27. Gjykata vëren se me ligjin nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, u parashikua krijimi i kësaj Gjykate, mënyra e organizimit dhe funksionimit, kompetencat e saj etj. Ky ligj parashikoi edhe rregullin e përtëritjes së përbërjes së Gjykatës çdo tre vjet, në një të tretën e saj, si dhe procedurën për realizimin e kësaj përtëritje. Për garantimin e parimit të përtëritjes gjatë gjithë vazhdimësisë së funksionimit të Gjykatës, u parashikua hedhja e shortit në fund të mandateve të para trevjeçare, me qëllim zëvendësimin gradual të gjyqtarëve të zgjedhur në fillimin e veprimtarisë së saj, për të arritur kështu në zëvendësimin periodik në mbarim të çdo mandati. Sipas këtij sistemi, emërimet e ardhshme në këtë detyrë do të ushtronin mandatin e plotë kushtetues dhe përtëritja e Gjykatës do të vijonte të kryhej çdo 3 vjet. Në këtë mënyrë do të realizohej qëllimi i ligjvënësit që gjithmonë në përbërje të Gjykatës të jenë dy të tretat e gjyqtarëve me stazh në detyrë jo më pak se tre vjet.

28. Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së vitit 1998, kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarëve kushtetues ndryshoi nga 12 vjet në 9 vjet, por parashikimi për përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e saj mbeti i pandryshuar (neni 125/3). Kushtetuta, në nenin 179/1 (dispozitat kalimtare dhe të fundit) parashikon se mandati i organeve kushtetuese që ekzistonin me hyrjen në fuqi të kësaj

Kushtetute mbaron me afatet e parashikuara në ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese. Kjo dispozitë kalimtare kushtetuese gjeti pasqyrim edhe në dispozitat kalimtare të ligjit organik të Gjykatës, konkretisht të neni 82, sipas të cilit mandati i gjyqtarëve të zgjedhur në vitin 1992 mbaronte në vitin 2001 dhe përtëritja e Gjykatës pas vitit 2001 do të bëhej sipas mbarimit të mandatit të secilit gjyqtar.

29. Dispozitat kalimtare rregullojnë momentin e kalimit nga një sistem në një tjetër, duke parashikuar mënyrën si do të zbatohen dispozitat e reja në lidhje me situatat faktike ose marrëdhëniet ekzistuese. Me plotësimin e këtij qëllimi (realizimin e këtij kalimi) ato e humbasin efektin e tyre. Gjykata vëren se si rezultat i zbatimit të parashikimeve të dispozitave të mësipërme kalimtare, në vitin 2010 mbaroi, njëkohësisht, mandati i tre gjyqtarëve të fundit, të cilët vazhduan të ushtronin detyrën për një mandat 12-vjeçar, si dhe mandati i tre gjyqtarëve që ishin zgjedhur për një mandat 9-vjeçar, bazuar në dispozitat e reja kushtetuese. Si pasojë, në situatën aktuale, mbaroi njëkohësisht mandati i gjashtë gjyqtarëve të Gjykatës, pra dy të tretat e përbërjes së saj, duke mos u respektuar urdhërimi kushtetues për përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet, me një të tretën e saj, sipas nenit 125/3 të Kushtetutës.

30. Gjykata thekson se çdo dispozitë e Kushtetutës duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese. Kjo për arsye se çdo dispozitë kushtetuese ka një lidhje të caktuar me dispozitat e tjera dhe së bashku ato formojnë një tërësi normash të harmonizuara. Për pasojë, asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete (*shih vendimet nr.2, datë 19.1.2005; nr.29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, Gjykata çmon se, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (*shih vendimin nr.20, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese në përputhje me parimet kushtetuese. Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë (jo të fituar nëpërmjet votës së zgjedhësve aktivë), parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë.

32. Bazuar në normat kushtetuese, një nga shkaqet për largimin e gjyqtarit nga detyra është mbarimi i kohëzgjatjes së mandatit të tij kushtetues. Neni 127 i Kushtetutës parashikon, në mënyrë shteruese, rastet e mbarimit të mandatit përpara përfundimit të afatit kushtetues, të cilat janë kur gjyqtari: dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi; nuk paraqitet pa arsye në detyrë për më shumë se 6 muaj; mbush moshën 70 vjeç; jep dorëheqjen; me vendim gjyqësor të formës së prerë deklarohet i paaftë për të vepruar. Po ashtu Kushtetuta (neni 128) parashikon edhe rastet kur mandati i gjyqtarit përfundon si pasojë e shkarkimit të tij nga Kuvendi: për shkelje të Kushtetutës; për kryerjen e një krimi; për paaftësi mendore a fizike; për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Për pasojë, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të largohet nga detyra vetëm me mbarimin e kohëzgjatjes së mandatit të tij kushtetues ose në një nga rastet e tjera të përmendura më sipër, pra vetëm për shkaqet e specifikuara në Kushtetutë.

33. Në ndryshim nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë, neni 125/5 i Kushtetutës parashikon se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës. Në ndryshim sa më sipër, mbarimi ose ndërprerja e mandatit të një gjyqtari kushtetues, në bazë të vendimit të organit që e ka zgjedhur atë dhe jo sipas një procedure ligjore të përcaktuar, me të cilën



gjqytari është njohur dhe e ka pranuar në momentin e zgjedhjes së tij, është e papajtueshme me parimet kushtetuese.

34. Për parashikimin kushtetues që ka vendosur rregullin/sistemin e përtëritjes periodike dhe të pjesshme të përbërjes së Gjykatës, kjo vëren se ky rregull/sistem është konsideruar se ka më shumë avantazhe se ai i përtëritjes tërësore, sepse në këtë mënyrë garantohet vazhdimësia e jurisprudencës dhe realizohet kombinimi i përvojës së Gjykatës (e paraqitur si shuma e koncepteve dhe qëndrimeve që janë bërë të qëndrueshme gjatë vendimmarrjes së një trupe të caktuar gjyqësore) me atë vetjake të gjyqtarëve të rinj, çka do të ishte më e vështirë në rast se mandati i të gjithë gjyqtarëve do të përfundonte në të njëjtën kohë. Funkzioni themelor i Gjykatës është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor, nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese. Rregullimi kushtetues i nenit 125/3 të Kushtetutës përbën një parim organizativ, i cili bazohet pikërisht në veçoritë specifike të procesit kushtetues që, përveç njohurive të gjyqtarëve, kërkon dhe përvojën e duhur. Ky rregullim ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve me stazh në detyrë, çka bën të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme dhe të specializuar në gjykimin kushtetues, e cila nuk mund të përftohet askund tjetër. Kjo bazë njohurish tekniko-juridike në fushën e gjykimin kushtetues, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes, konsiderohet nga Gjykata si një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta.

35. Përtëritja e Gjykatës çdo tre vjet, me një të tretën e gjyqtarëve, është mjet për të garantuar pavarësinë e saj, sepse mandati i gjyqtarëve nuk përplasat me kohëzgjatjen e mandatit presidencial dhe atë parlamentar, por i tejkalon ato.

36. Në përfundim të këtij arsytimi, Gjykata thekson se respektimi dhe zbatimi i parashikimit kushtetues të përtëritjes së përbërjes së saj çdo tre vjet, në një të tretën e anëtarësisë, paraqet rëndësi të veçantë në kuptim të ruajtjes dhe forcimit të pavarësisë dhe vazhdimësisë së këtij organi.

37. Gjykata rithekson se në zbatim të parimit bazë të shtetit të së drejtës, atij të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, kushtetutbërësi ka përcaktuar, për secilin nga organet që përfaqësojnë këto pushtete, kompetencat që përputhen/i përgjigjen qëllimit të tij. Për sa kohë këto kompetenca janë të përcaktuara nga normat kushtetuese, është e palejueshme që një organ tjetër t'i marrë ose t'i anashkalojë ato me vullnetin e tij.

38. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në situatën aktuale, kur ka mbaruar mandati i dy të tretave të gjyqtarëve të saj, ka lindur një problem kushtetues, por nuk është vendimi interpretues që mund t'i japë zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes. Përcaktimi, nga ana e Gjykatës, i një mekanizmi për të ruajtur balancën ndërmjet respektimit të rregullit të përtëritjes periodike e të pjesshme të kësaj Gjykate dhe parimit të garantimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues, do ta nxirrte atë jashtë juridiksionit kushtetues. Gjykata vlerëson se funksioni i saj, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës është interpretimi i dispozitës me qëllim përfundimin e kuptimit normativ të teksit kushtetues duke ndjekur teknikat e njohura të interpretimit në gjykimin kushtetues. Në rastin konkret, nuk është interpretimi i pasaktë ose kuptimi i gabuar i kësaj norme kushtetuese që ka çuar në situatën konkrete të mosrespektimit të parashikimit kushtetues të nenit 125/3 të Kushtetutës.

39. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues që të gjejë dhe të zbatojë mekanizmin e përshtatshëm për të respektuar parimin kushtetues të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet në një të tretën e saj.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 124 dhe nenit 134, pika 1, shkronja "c" të Kushtetutës, si dhe të neneve 71, 72 dhe 79 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

## VENDOSI:

- Interpretimin e nenit 125 të Kushtetutës, si vijon:

Neni 125 i Kushtetutës sanksionon dy parime të rëndësishme për garantimin e pavarësisë së Gjykatës Kushtetuese: parimi i qëndrueshmërisë në përbërjen e Gjykatës dhe parimi i garantimit të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues.

- Interpretimin e nenit 125/2 të Kushtetutës, si vijon:

Gjatë ushtrimit të kompetencave kushtetuese për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë janë interpretuesit e parë të normës kushtetuese, prandaj bazuar në parimin e luajalitetit kushtetues, duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kriterëve ligjore në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, për të siguruar një përbërje cilësore të kësaj Gjykate.

- Interpretimin e nenit 125/3 të Kushtetutës, si vijon:

1. Parashikimi i nenit 125/3 të Kushtetutës përbën një parim organizativ, i bazuar në veçoritë specifike të procesit kushtetues dhe që ka për qëllim ruajtjen në përbërje të Gjykatës Kushtetuese të një shumice prej dy të tretave të anëtarëve në detyrë, duke bërë të mundur krijimin e një përvoje juridike të posaçme në fushën e gjykimit kushtetues. Kjo përvojë e përftuar nga Gjykata, duke qenë se ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes së saj, konsiderohet një vlerë e mbrojtur nga Kushtetuta.

2. Gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është kompetencë e ligjvënësit kushtetues.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Sokol Berberi

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Petrit Pllloçi

## MENDIM PAKICE

Jam i mendimit se kërkesa e paraqitur nga një e pesta e deputetëve të Kuvendit, nuk përmbush kriteret kushtetuese për t'u pranuar si për mungesë legjitimitimi, ashtu dhe për mungesë juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për zgjidhjen e çështjeve të ngritura para saj.

1. Me të drejtë shumica, kur i referohet nenit 127 të Kushtetutës dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", vëren se funksioni bazë i kësaj Gjykate është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj.

2. Ky funksion themelor i Gjykatës, me rëndësi të jashtëzakonshme për funksionimin dhe përsosjen e mëtejshme të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, kërkon domosdoshmërisht konsolidimin dhe përsosjen e jurisprudencës së saj si për sa i përket nivelit të vendimmarrjes brenda caqeve të kompetencave të parashikuara nga Kushtetuta, ashtu edhe kushteve, si dhe kriterëve që duhet të përmbushin subjektet që e venë atë në lëvizje për të iniciuar një gjykim kushtetues për interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese. Në këtë kuptim çështja, objekt shqyrtimi, paraqet interes të veçantë.

3. Në pikën 9.1 të vendimit shumica thekson se Gjykata mund dhe duhet të investohet vetëm nëse interpretimi që i kërkohet është i lidhur me një mosmarrëveshje konkrete, që ka lindur si pasojë e zbatimit ose kuptimit të ndryshëm/gabuar të normës kushtetuese dhe se ajo bën interpretimin e normës kushtetuese vetëm nëse vlerëson se gjendet para një "problemi kushtetues" dhe synon zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Nëse do të pranohet një interpretim *ad contrario*, vazhdon shumica më tej, Gjykata do të gjendej para një situatë ku produkt i interpretimit do të ishin opinione për mënyrën se si duhet të sillen, në të ardhmen, institucionet shtetërore ose do të përfundonte, duke ushtruar një kontroll *ex ante* të veprimtarisë së këtyre institucioneve, pa pasur një mosmarrëveshje konkrete.

4. Më tej, në pikën 9.2, shumica nënvizon se që Gjykata të shprehet për interpretimin e normës kushtetuese në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme. Dhe më tej, duke iu referuar jurisprudencës së kësaj Gjykate, shumica citon pjesë nga vendimet e saj, në të cilat vihet në dukje se: “Gjykata ka vlerësuar se qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi përfundimtar, pasi kjo krijon mundësinë e mënjanimit të mosmarrëveshjeve ose paqartësive që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i tyre.

5. Arsyetimet e përdorura nga shumica në pikat 9.1 dhe 9.2 të vendimit, në tërësi, janë të njëjta me argumentet që dha pakica, sipas së cilës meqenëse kërkesa e paraqitur nga 1/5 e deputetëve, nuk përmbushte standardet formale dhe substanciale për të iniciuar një interpretim përfundimtar të normës kushtetuese duhej rrëzuar si e pabazuar.

6. Në vijim, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur më lart, shumica (*shih pikat 11 dhe 12 të vendimit*) legjitimon kërkuesin dhe pranon juridiksionin e kësaj Gjykate. Argumentet e përdorura, duke qenë të pasakta, e bëjnë vendimin konfuz dhe kontradiktor.

Lidhur me legjitimitimin e një të pestës të deputetëve të Kuvendit për të vënë në lëvizje Gjykatën për interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese.

7. Jo më pak se një e pesta e deputetëve bëjnë pjesë në rrethin e subjekteve që, sipas nenit 134 të Kushtetutës, kanë të drejtë të vënë në lëvizje këtë Gjykatë pa e kushtëzuar me interesin e tyre. Megjithatë ky subjekt, ashtu si dhe të tjerët të përmendur në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të nenit 134, kur bëhet fjalë për të kërkuar një gjykim kushtetues për interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese nuk mund ta ushtrojnë këtë të drejtë në mënyrë të pakufizuar. Kërkesat e tyre duhet detyrimisht të plotësojnë disa kushte, të cilat janë me natyrë kushtetuese dhe ligjore.

8. Kushtetutëbërësi, jo pa qëllim, në nenin 124 të Kushtetutës e ka ngarkuar Gjykatën Kushtetuese me kompetencën për të bërë interpretimin përfundimtar (vini re) të Kushtetutës.

9. Interpretimi i Kushtetutës është një funksion i natyrshëm i çdo institucioni, veprimtaria e të cilit është e lidhur me kompetencat e ngarkuara nga Kushtetuta. Në këtë kuptim Presidenti i Republikës, Kuvendi, Këshilli i Ministrave apo çdo institucion tjetër me natyrë kushtetuese, gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre në veprimtarinë e përditshme nëpërmjet zbatimit të Kushtetutës, reflektojnë/shprehin njëkohësisht qëndrimin e tyre për mënyrën se si ata e kanë kuptuar dhe interpretuar normën përkatëse kushtetuese.

10. Me qëllim që ky proces të jetë transparent e i lexueshëm, si dhe të mund t’i nënshtrohet vlerësimit në kuptimin kushtetues, kusht i domosdoshëm është që shprehja e vullnetit të institucionit, pas vendimmarrjes të tij, të jetë pasqyruar në aktet përkatëse juridike, si: dekrete, vendime, rregullore etj. Opinione apo nismat e ndërmarra në mënyrë të njëanshme jashtë vendimmarrjes të organeve kushtetuese kompetente për të kundërshtuar një vendimmarrje të një organi tjetër kushtetues, nuk mund të legjitimojnë askënd për të vënë në lëvizje këtë Gjykatë për të bërë interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese.

11. Shumica arsyeton se për të iniciuar një gjykim kushtetues për interpretimin përfundimtar të Kushtetutës duhet të jetë krijuar “një problem” (*shih pikat 9.1 dhe 9.2 të vendimit*). Ky term i përdorur nga shumica është shumë i përgjithshëm dhe i pasaktë në kuptimin kushtetues. Sipas pikëpamjes sime, nuk bëhet fjalë për një “problem”, por për një çështje me natyrë kushtetuese për të cilën dy organe të ndryshme, kompetente për zgjidhjen përfundimtare të saj, nuk janë në një mendje lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të normës kushtetuese. Për rrjedhojë, siç shprehet dhe shumica, është krijuar një konflikt midis organeve. Kjo buron jo vetëm nga fryma e Kushtetutës, por del edhe nga përmbajtja e nenit 71, pikat 3 dhe 4 të ligjit organik të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se kërkuesit (subjektet e përmendura në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të paragrafit 1 të nenit 134 të Kushtetutës), në kërkesën e paraqitur duhet të saktësojnë veç dispozitës që kërkohet të interpretohet edhe subjektin, që pretendohet se e ka interpretuar gabim Kushtetutën, i cili duhet të jetë palë në gjykim.

12. Shtrohet çështja, a i plotëson kërkesa e paraqitur nga një e pesta e deputetëve standardet e mësipërme? Që do të thotë, së pari, a shpreh kërkesa vullnetin/qëndrimin zyrtar të Kuvendit, të

bazuar mbi një vendimmarrje të tij; dhe së dyti, a përmban ajo argumente sipas të cilave Kuvendi (vini re) në çështjen e dekretimeve nga ana e Presidentit të Republikës ka opinion të kundërt me këtë institucion për kuptimin dhe interpretimin e normave juridike kushtetuese që lidhen me rotacionin në Gjykatën Kushtetuese, si dhe me kriteret që duhet të përmbushin kandidatët për anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese?

13. Nga pikëpamja formale dhe substanciale, kërkesa, ndryshe nga sa pranon shumica në vendimin e saj (shih pikën 11), jo vetëm nuk i referohet ndonjë vendimmarrjeje të Kuvendit (dhe këtu shumica gabon kur opinionin e një të pestës së deputetëve e njëson me atë të Kuvendit si organ kushtetues), por nga ana tjetër nuk përmban asnjë argument apo pretendim që të vërtetojë se Presidenti i Republikës, me rastin e dekretimit të anëtarëve të rinj të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të ketë interpretuar dhe zbatuar gabim Kushtetutën. Kërkesa nuk është gjë tjetër veçse një pyetësor, i cili fton Gjykatën për të dhënë opinionin e vet, gjë që del jashtë natyrës kushtetuese të këtij organi, Për më tepër, edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi nuk arriti të paraqesë argumente për çështjet e trajtuara më lart, duke mbetur thjesht në kuadrin e konsideratave personale.

Lidhur me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

14. Shumica, ndonëse ka bërë përpjekje për t'i konsideruar brenda juridiksionit të kësaj Gjykate një pjesë të pretendimeve të kërkuetit, duke u përqendruar kryesisht në interpretimin e nenit 125 të Kushtetutës, nuk ka arritur të argumentojë qëndrimin e vet, për pasojë përfundimet e arritura në dispozitivin e vendimit janë tepër të përgjithshme dhe në kontradiktë me pjesën arsyetuese.

15. Për emërimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, kushtetutëbërësi në formulimin e dispozitave përkatëse (neni 125/1 dhe neni 136/1 të Kushtetutës) ka demonstruar vullnetin e tij që ky proces të jetë luajal, por edhe konsensual midis Presidentit të Republikës dhe Kuvendit, duke konsideruar mbi të gjitha meritat e kandidatëve sipas parashikimeve në normat përkatëse kushtetuese, si dhe në ligjet e tyre organike. Për këtë çështje ka dhe një vendim të kësaj Gjykate për interpretimin përfundimtar të neneve 125/1 dhe 136/1 të Kushtetutës, në pjesën arsyetuese të të cilit thuhet se sistemi i emërimit, i adoptuar nga Kushtetuta, i vë subjektet e përfshira në të para kërkesës për respektimin e parimit të luajalitetit kushtetues dhe parakupton krijimin e një raporti bashkëpunimi midis tyre (shih vendimin nr.2, datë 19.1.2001 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Shumica, duke u përpjekur të interpretojë pikën 2 të nenit 125 të Kushtetutës, i shtrin këto parime edhe në çështjen e plotësimit të kuadrit ligjor e kushtetues lidhur me meritat, kur shprehet se Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kriterëve ligjore në përputhje me kërkesën kushtetuese për kualifikim të lartë, për të siguruar një përbërje cilësore të kësaj Gjykate.

17. Shumica, me këtë mënyrë interpretimi, është e paqartë dhe njëkohësisht jokorrekte në raport me kërkuetin. Ky i fundit kërkon përgjigje lidhur me kriteret ligjore që duhet të përmbushin anëtarët e të dyja gjykatave, nëse duhet të ketë dallime midis tyre, nëse mund të shtohen kriteret të reja të meritës nga ana e Kuvendit etj.

18. Jam i mendimit se çështja e plotësimit të kriterëve ligjore, që lidhen me meritën e kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, del jashtë juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe, si e tillë, kërkesa duhet rrëzuar si e pabazuar edhe në këtë pjesë të saj. Është kompetencë ekskluzive e Kuvendit që nëpërmjet ndërhyrjeve në Kushtetutë dhe, në pamundësi të tyre, të ndërhyrjeve në ligjet organike të të dyja gjykatave, të përmirësojnë apo përsosin më tej kuadrin ligjor në funksion të meritës së kandidatëve për anëtarë në këto institucione kushtetuese.

19. Shumica, kur shprehet në dispozitivin e vendimit se Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e kriterëve ligjore, nuk ka bërë interpretimin e pikës 2 të nenit 125 të Kushtetutës, siç pretendon në vendim, por, përkundrazi, ka orientuar këto institucione që të ndërmarrin nisma ligjore të reja. Në këtë mënyrë shumica, në thelb, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit të kësaj Gjykate, duke përcaktuar njëkohësisht kompetencën e institucioneve të përmendura më lart për zgjidhjen e çështjes konkrete.

20. Gjithashtu, të njëjtën gjë ka bërë shumica edhe lidhur me një element tjetër të kërkesës, atë të interpretimit të normës kushtetuese për rotacionin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese kur në dispozitivin e vendimit është shprehur se: “Gjetja dhe zbatimi i një mekanizmi të përshtatshëm për të respektuar nenin 125/3 të Kushtetutës, është në kompetencë të ligjvënësit kushtetues”.

Anëtar: Vladimir Kristo

## MENDIM PAKICE

Nuk jam dakord me vendimin e dhënë lidhur me këtë çështje, për arsye që vijojnë:

1. Siç rezulton nga vendimi i shumicës, në muajin shtator 2010 Presidenti i Republikës (këtu e më pas Presidenti), ka emëruar me dekret katër anëtarë të Gjykatës Kushtetuese (këtu e më pas GJK) dhe tre anëtarë të Gjykatës së Lartë (këtu e më pas GJL). Këto dekrete i janë dërguar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (këtu e më pas Kuvendi) për dhënie pëlqimi, në mbështetje të neneve 125/1 dhe 136 të Kushtetutës.

2. Kuvendi ka pezulluar procedurat për votimin për dhënien e pëlqimit për dekretet e mësipërme të Presidentit, dhe një e pesta e deputeteve të Kuvendit i janë drejtuar GJK-së, në bazë të nenit 134/1/c të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (këtu e më pas Kushtetuta), duke kërkuar interpretimin e nenit 125, pikat 1, 2, dhe 3, dhe të nenit 136, pikat 1 dhe 5 të Kushtetutës.

3. Sipas palës kërkuese, interpretimi i këtyre dispozitave është i nevojshëm për sqarimin e kritereve që duhet të plotësojnë kandidatët për gjyqtarë; nëse ka konflikt kushtetues në rastin e parashikimit të kritereve të njëjta për gjyqtarët e këtyre dy gjykatave; nëse duhet të ketë ndonjë raport në përbërjen e GJL-së mes gjyqtarëve që vijnë nga pushteti gjyqësor dhe juristëve jashtë këtij sistemi; nëse kandidaturat për gjyqtar duhet t'i plotësojnë kriteret në momentin e dekretimit apo në momentin e dhënies së pëlqimit në Kuvend; se cili mund të jetë mekanizmi i vlefshëm, në respekt të nenit 125/3 të Kushtetutës, për përtëritjen çdo tre vjet të një të tretës së gjyqtarëve të GJK-së.

4. Siç jam shprehur edhe në raste të tjera, të ngjashme me çështjen në shqyrtim, rezerva ime ka të bëjë me mungesën e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e kërkesës së mësipërme, me objekt interpretimin e neneve 125 e 136 të Kushtetutës, kërkesë, e cila për mendimin tim, kërkon nga Gjykata Kushtetuese dhënien e një opinioni këshillimor *in abstracto* – gjë që nuk përfshihet në juridiksionin e kësaj Gjykate, të përcaktuar, kryesisht, në nenin 131 të Kushtetutës.

5. Kërkuesit e mbështesin kërkesën për interpretim jo në nenin 131 të sipërpërmendur, por në nenin 124 të Kushtetutës, sipas të cilit “Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”.

6. Mendoj se kjo dispozitë nuk mund të përbëjë një bazë juridiko-kushtetuese të vlefshme për të pranuar juridiksionin e GJK-së për gjykimin e kërkesës. Neni 124 i Kushtetutës nuk rregullon rastet/çështjet që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, por si dispozitë e parë e bllokut të dispozitave që rregullojnë pozitën e kësaj Gjykate, si organ kushtetues, ka për qëllim të përcaktojë, në esencë, funksionin e kësaj Gjykate, që është garantimi i respektimit të Kushtetutës dhe interpretimi përfundimtar i saj, ndërsa “rastet/çështjet” se, kur kjo Gjykatë investohet për të realizuar funksionin e saj interpretues, specifikohen në dispozita të tjera. Kjo do të thotë, se GJK-ja e interpreton Kushtetutën jo *in abstracto*, por për të vendosur/zgjidhur një nga rastet/çështjet që përcaktohen, kryesisht, në nenin 131 të Kushtetutës, e jo si qëllim në vetvete. Në rast se neni 124 do të kishte për qëllim rregullimin e juridiksionit të GJK-së, atëherë edhe rastet/çështjet që përbëjnë juridiksion kushtetues, do të parashikoheshin, kryesisht, në këtë dispozitë. Kjo do të thotë se neni 124 është një dispozitë me karakter deklarativ e të përgjithshëm, që nuk merr përsipër të detajojë juridiksionin kushtetues, por vetëm deklaron funksionin themelor të kësaj Gjykate, që është mbrojtja e Kushtetutës. Janë dispozita të tjera të Kushtetutës (kryesisht, nenet 131, 115, 128 etj.), ato që përcaktojnë juridiksionin e Gjykatës. Pra, këto dispozita të fundit, përcaktojnë rastet/çështjet, që bëhen shkak për interpretimin kushtetues, dhe ky interpretim nuk ka qëllim në vetvete, por pikërisht për të vendosur për këto raste/çështje.

7. Konkluzioni i mësipërm mbështetet edhe në një vështrim historik të çështjes së juridiksionit të GJK-së, dhe në mënyrë të veçantë, të interpretimit *in abstracto*- si pjesë e këtij juridiksioni.

8. Kështu, sipas nenit 24 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, i cili është ligj kushtetues, “Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca:

1. Bën interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese.

2. Gjykon papajtueshmërinë e ligjeve dhe të akteve që kanë fuqinë e ligjit me Kushtetutën.

3. Gjykon papajtueshmërinë e akteve dhe dispozitave nënligjore me Kushtetutën dhe me ligjin. ... etj.” Pra, siç shihet, neni 24 i këtij ligji kushtetues fillonte me shprehjen “Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca:”, dhe bënte një listë të këtyre kompetencave, duke u shprehur në pikën 1 të kësaj dispozite se [Gjykata Kushtetuese] . . . bën interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese. Është e qartë se kjo dispozitë e ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, listonte kompetencat e GJK-së, pra përcaktonte juridiksionin e saj, duke përfshirë në pikën 1 të saj edhe interpretimin e Kushtetutës dhe të ligjeve kushtetuese, pa e kushtëzuar me ndonjë “rast” apo “çështje”, gjë që do të thotë se ka pranuar edhe interpretimin *in abstracto*. Kjo do të thotë se kuadri i mëparshëm kushtetues e ngarkonte GJK-në edhe me interpretimin *in abstracto*, por Kushtetuta e 1998 hoqi dorë nga ky lloj interpretimi.

9. Një qëndrim të përafërt me të mësipërmin, ka mbajtur Gjykata Kushtetuese edhe në një vendim të saj në një çështje me kërkues një grup deputetësh të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt interpretimin e neneve 69, 70, 71 e 72 të Kushtetutës, ku është shprehur se kompetenca interpretuese e saj, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, nuk duhet të interpretohet se nënkupton formulimin e interpretimeve tërësisht abstrakte ...; [se në të kundërtën] ... Gjykata do të gjendej para një situatë ku produkti i interpretimit do të ishin opinione këshillimore për mënyrën se si duhet të sillen në të ardhmen institucionet shtetërore ...; [dhe] se nuk është në ... funksionin e saj të parashikojë të gjitha interpretimet e mundshme të normave të Kushtetutës, nëse ato nuk janë të lidhura me mosmarrëveshje konkrete.

10. Për sa sipër, mendoj se neni 124 i Kushtetutës nuk mund të aplikohet si bazë kushtetuese për t’i dhënë juridiksion kësaj Gjykate për të bërë interpretim pa pasur një “rast” apo “çështje”.

11. Në vendim, shumica ka parashtruar kriteret që duhet të plotësohen për interpretimin e normës kushtetuese në bazë të nenit 124 të Kushtetutës.

12. Ndërmjet të tjerash, shumica është shprehur se për interpretimin e normës kushtetuese, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës ...Gjykata mund të investohet vetëm nëse interpretimi ... është i lidhur me një mosmarrëveshje konkrete, që ka lindur si pasojë e zbatimit ose kuptimit të ndryshëm të normës kushtetuese...; [dhe] së dyti, kërkohet që organet, të cilat zbatojnë normën kushtetuese, të kenë mbajtur qëndrimin e tyre për kuptimin/interpretimin e kësaj norme; [dhe se] qëndrimet e mbajtura nga një organ për interpretimin e normave konkrete të Kushtetutës, që shprehen nëpërmjet vendimeve të këtij organi, janë të mjaftueshme për kryerjen e një interpretimi...

13. Jam dakord me kriteret e mësipërme, të cilat për mendimin tim kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të një mosmarrëveshje kompetencash midis pushteteve, në kuptim të pikës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës. Por, në rastin në shqyrtim, nuk plotësohen këto kritere. Një nga këto është që autoritetet kushtetuese ta kenë shprehur vullnetin e tyre nëpërmjet akteve juridiko-kushtetuese të vlefshme. Konkretisht, në rastin në shqyrtim, ku kemi të bëjmë me një procedurë për emërimin e katër gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe tre gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, marrin pjesë si organe kushtetuese Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë, dhe si akte të tilla kushtetutshmërisht të vlefshme janë dekreti, në rastin e Presidentit dhe vendimi për dhënien ose jo të pëlqimit, në rastin e Kuvendit. Presidenti i Republikës, si njëri nga këto organe që merr pjesë në këtë procedurë, e ka shprehur vullnetin e tij, nëpërmjet dekreteve të emërimit, ndërsa Kuvendi si organi tjetër kushtetues, nuk e ka shprehur akoma këtë vullnet, për të dhënë ose jo pëlqimin sipas nenit 125/1 të Kushtetutës, por e ka pezulluar procedurën e dhënies së pëlqimit, duke i kërkuar interpretimin Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, mendoj se nuk ndodhemi as në kushtet e një konflikti pushtetesh, gjë që do të legjitimonte juridiksionin e kësaj Gjykate.

14. Për sa sipër, mendoj që kërkesa e paraqitur nuk duhet të pranohej për shqyrtim për mungesë juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese.

Anëtar: Petrit Ploçi

**VENDIM**  
**Nr.25, datë 10.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“ “
Petrit Ploçi	Anëtar	i	“ “
Vitore Tusha	Anëtare	e	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“ “
Sokol Berberi	Anëtar	i	“ “
Admir Thanza	Anëtar	i	“ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 23.11.2010 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26/11 akti, që i përket:

**KËRKUES:** Saimir Elmazi, përfaqësuar nga avokati Agim Hysi dhe avokati Arjan Salati, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga Artur Selmani, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.615, datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, Bashkim Dedja; përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuarisi është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës me vendimin nr.845, datë 21.9.2004 me 18 vjet burgim për kryerjen e veprave penale të “vrasjes me dashje kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 76 dhe 25 të Kodit Penal dhe të “mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

2. Me vendimin nr.375, datë 6.6.2005 Gjykata e Apelit të Tiranës ka ndryshuar vendimin e mësipërm për sa i përket bashkëpunimit (duke pushuar procedimin për të pandehurin tjetër) dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës për kërkuarisen, duke e dënuar me 18 vjet burgim për veprat penale “vrasje me dashje” dhe “armëmbajtje pa leje”.

3. Kërkuarisi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me rekurs. Me vendimin nr.545, datë 4.10.2006 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit të Tiranës nr.375, datë 6.6.2005 për sa i përket të gjykuarit Sajmir Elmazi.

4. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim. Me vendimin nr.00-2010-615, datë 14.5.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) ka vendosur: *“Mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimeve nr.845, datë 21.9.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës, ndryshuar me vendimin nr. 375, datë 6.6.2005 të Gjykatës së Apelit të Tiranës, lënë në fuqi me vendimin nr.545, datë 4.10.2006 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë”*.

5. Kërkuesi në datën 12.7.2010 i është drejtuar Gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.615, datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për këto arsye:

5.1 Gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuetit ose të mbrojtësit të zgjedhur prej tij, si dhe pa njoftim për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit.

5.2 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është mjaftuar vetëm me shprehjet se: Deklaratat e administruara dhe akti ekspertimit nuk përbëjnë provë në kuptim të nenit 450/c të Kodit të Procedurës Penale, nëse do të pranohej si provë përmbajtja e aktit të ekspertimit nuk tregojnë që vendimet e gjykatave janë të gabuara. Ky Kolegj nuk ka treguar me qartësi të mjaftueshme arsyet mbi të cilat ka mbështetur vendimin e tij, prandaj dhe arsyetimi nuk është i plotë.

5.3 Është cenuar parimi i paanësisë, sepse dy gjyqtarë të Kolegjit Penal, në shqyrtimin e kërkesës për rishikim, kanë qenë pjesëmarrës dhe në gjykimin e çështjes me rekurs.

6. *Subjekti i interesuar* ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, me këto pretendime:

6.1 Procedura e gjykimit në Gjykatë të Lartë zhvillohet sipas dispozitave procedurale pa praninë e të pandehurve në proces dhe mospranimi i mbrojtësit jo gjithmonë prek të drejtën e kërkuetit për t’u mbrojtur në gjykim.

6.2 Vendimi i Kolegjit Penal është i arsyetuar, sepse lehtësisht në të vërehen arsyet e refuzimit të kërkesës për rishikim.

6.3 Pjesëmarrja e dy gjyqtarëve në shqyrtimin e kërkesës për rishikim nuk cenon parimin e paanësisë, sepse ky parim cenohet kur i njëjti gjyqtar ose gjykon të njëjtën çështje në rolin e një gjyqtari të një gjykate më të lartë, ose rigjykon të njëjtën çështje të kthyer për rigjykim nga një gjykatë më e lartë. Në rastin konkret dy gjyqtarët nuk kanë qenë në rolin e një gjykatë më të lartë, që shqyrtojnë bazueshmërinë e një gjykimi të mëparshëm të kryer prej tyre.

## II

*Për pretendimin se kërkuetit i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar*

7. Kërkuesi pretendon se vendimi nr.615, datë 14.5.2010 i Kolegjit Penal është antikushtetues, pasi nuk është dëgjuar, çka, sipas tij, e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

8. Për këtë pretendim, Gjykata ka vlerësuar në mënyrë të konsoliduar gjatë vendimmarrjes së saj, se nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, si dhe kur këto pretendime, gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit Penal për mospranim të kërkesës për rishikim vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Sipas Gjykatës “... e gjithë veprimtaria seleksionuese e Dhomës së Këshillimit nuk është një shkelje e të drejtës së palëve për t’iu drejtuar gjykatës, por është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, Dhoma e Këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim, por nëse këto kritere plotësohen, gjykata nuk mund të vendosë drejtpërdrejt prishjen e vendimit, pa respektuar parimet kushtetuese të dëgjimit të palëve e të barazisë së mjeteve” (*shih vendimet nr.4, datë 25.2.2009; nr.5, datë 26.1.2007; nr.8, datë 2.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Nga kjo analizë, Gjykata konkludon se pretendimi i kërkuetit për parregullsinë e procesit ligjor, për shkak të kompetencave që ligji i ka dhënë Kolegjit Penal për gjykim në Dhomë Këshillimi gjatë vlerësimit të kërkesës për rishikim, është i pabazuar.

*Për pretendimin se kërkuetit i është mohuar e drejta e mbrojtjes vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor*



10. Kërkuesi pretendon se gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit ose të mbrojtësit të zgjedhur prej tij, si dhe pa u njoftuar për ditën dhe orën e zhvillimit të gjykimit. Atij nuk i është dhënë mundësia për pjesëmarrje personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.

11. Gjykata vlerëson se e drejta e palëve për të qenë të pranishëm dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Në mënyrë konstante, në një sërë vendimesh të saj, Gjykata e ka pranuar ekzistencën e mbrojtjes si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve (*shih vendimet nr.5, datë 17.2.2003 dhe nr.33, datë 24.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). E drejta e gjithkujt, të akuzuar penalisht, për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë.

12. Gjykata rithekson se parimi i kontradiktoritetit dhe i barazisë së armëve në gjykimin penal kërkon që argumentet e mbrojtjes të paraqiten dhe të dëgjohen njëjloj si ato të prokurorit. Ky parim presupozon që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme për të paraqitur pretendimet për çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër (*shih vendimin nr.5, datë 17.2.2003 i Gjykatës Kushtetuese*). Për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rreptësi një sërë detyrimesh, mes të cilave, sipas rastit, rëndësi të veçantë paraqet edhe njoftimi i të pandehurit ose i mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes etj. (*shih vendimet: nr.19, datë 18.9.2008; nr.13, datë 21.7.2008; nr.16, datë 8.6.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke pasur parasysh argumentimin e mësipërm, sipas të cilit kërkuesit nuk i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar nga Kolegji Penal (Dhomë e Këshillimit), Gjykata vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e të drejtës së mbrojtjes së kërkuesit nuk qëndron.

*Për pretendimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka arsyetuar vendimin*

14. Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal nuk e ka arsyetuar vendimin nr.615, datë 14.5.2010, ku ka vendosur refuzimin e kërkesës për rishikim, duke shkelur detyrimin për arsyetimin e vendimeve nga ana e gjykatave, si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

15. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore (detyrim i sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës) si një garanci për procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet: nr.8, datë 16.3.2011; nr.38, datë 30.12.2010; nr.7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se një funksion tjetër i arsyetimit të vendimit është t'u demonstrojë palëve se ata janë dëgjuar. Për më tepër një vendim i arsyetuar i jep mundësinë palëve ta apelojnë atë, si dhe organeve të apelit ta shqyrtojnë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin Sarban kundër Moldavisë, prg.98, datë 4 tetor 2005*).

16. GJEDNJ-ja është shprehur për arsyetimin e vendimeve se detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështje konkrete dhe natyrës së vendimit (*Hirvisaari kundër Finlandës, prg 30, vendim i datës 27 shtator 2001*).

17. Megjithatë, Gjykata ka përcaktuar disa aspekte në drejtim të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si pjesë e procesit të rregullt ligjor. Sipas saj "Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në gjetjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Argumentet e dhëna në vendim duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik" (*shih vendimet: nr.38, datë 30.12.2010; nr.23, datë 23.7.2009; nr.7, datë 9.3.2009; nr.11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në vijimësi ajo është shprehur se: “Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë juridik. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie të hapur ose të fshehtë” (*shih vendimin nr.5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Po sipas kësaj Gjykate, “Gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Megjithatë, edhe pse neni 42 i Kushtetutës i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument” (*shih vendimin nr.23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Penal ka dhënë dy argumente për mospranimin e kërkesës për rishikim: së pari, se deklaratat e administruara të tre shtetasve, sipas të cilëve kërkuesi Saimir Elmazi nuk është autor i vrasjes, dhe akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr.17, datë 11.9.2009 i klinikës ligjore “Fisher Splitz” nuk përbënin provë në kuptim të nenit 450/c të K.Pr.Penale, dhe së dyti edhe sikur akti i ekspertimit mjeko-ligjor të kishte pasur cilësinë e provës së re, sipas kuptimit që i jep provave K.Pr.Penale, përmbajtja e tij nuk tregon se vendimet e gjykatave janë të gabuara.

19. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se argumentet e kërkuesit për mosarsyetim të vendimit nr.615, datë 14.5.2010 të Kolegjit Penal janë të pabazuara.

*Për pretendimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e paanësisë*

20. Kërkuesi pretendon se është shkelur parimi i paanësisë, pasi dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë kanë marrë pjesë në dy gjykime të iniciuara nga ai. Dy gjyqtarët (BY dhe GD) kanë qenë pjesëmarrës në Kolegjin Penal, ku është shqyrtuar rekursi i paraqitur nga kërkuesi dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të Gjykatës së Apelit duke e lënë në fuqi atë. Të njëjtët gjyqtarë kanë shqyrtuar edhe kërkesën për rishikim në Dhomën e Këshillimit, e cila ka vendosur mospranimin e kërkesës.

21. Gjykata thekson se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim te publiku dhe, mbi të gjitha, te palët në proces. Për këtë qëllim neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr.38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

Me këtë rast, Gjykata përsërit se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet, duke zbatuar testin objektiv me të cilin shqyrtohet, nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë dhe testin subjektiv që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar (*shih vendimet: nr.7, datë 11.3.2008; nr.11, datë 2.4.2008; nr.23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm (*shih vendimin nr.10, datë 2.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. GJEDNJ-ja ka pohuar se “... Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit, që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm”, si dhe “... fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo

që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor (*shih vendimin Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005*).

23. Për t'u shprehur për këtë pretendim, Gjykata e çmon të nevojshme të ripërsërisë vlerësimet e jurisprudencës së saj për funksionin rishikues të Gjykatës së Lartë, parashikuar në nenin 141 të Kushtetutës, sipas të cilit ajo duhet të zbatojë të drejtën mbi faktet, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë, në mënyrë të njësuar në të gjithë sistemin gjyqësor. Në këtë koncept është mbështetur neni 141 i Kushtetutës, duke përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatë që kompetencën e saj për funksionin rishikues ta zbatojë brenda kompetencave të saj dhe duke zhvilluar një procedurë të përcaktuar në mënyrë rigorozë nga ligji dhe Kushtetuta (*shih vendimin nr.31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren se kërkesa për rishikim, sipas nenit 450 të K.Pr.Penale, mund të kërkohej: a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë; b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas; c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë tregojnë se vendimi është i gabuar; ç) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale. Sipas nenit 453/2 të K.Pr.Penale, Kolegji Penal në Dhomën e Këshillimit ka kompetencën të vlerësojë ekzistencën ose jo të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës në një shqyrtim seleksionues brenda rasteve të përcaktuara nga neni 450 i K.Pr.Penale dhe nuk lidhet me vlerësimin e zgjidhjes së çështjes nga pikëpamja ligjore ose faktike. Ndërsa sipas nenit 432 të K.Pr.Penale, Kolegji Penal ka në kompetencë të shqyrtojë problemet e ngritura në rekurs, që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave.

25. Gjykata vlerëson se gjyqtari, që shqyrton kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, nuk kryen vlerësime të reja, në themel, të të njëjtave fakte të vlerësuara nga gjykata në gjykimin e themelit, por ai kryen një vlerësim, për herë të parë, të fakteve/provave të reja, të cilat nuk kanë qenë më parë objekt gjykimi, diskutimi dhe vlerësimi nga gjykatat që kanë dhënë vendimin për të cilin bëhet rishikimi. Rishikimi i vendimit si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj, që në asnjë mënyrë nuk përfshijnë veprimtarinë vlerësuese të gjyqtarit në gjykimin që kërkohej/pranohet të rishikohet.

26. Duke analizuar rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Kolegji Penal ka refuzuar kërkesën për rishikim, me arsyetimin se deklaratat e tre shtetasve, sipas të cilëve kërkuesi Saimir Elmazi nuk është autor i vrasjes, dhe akti ekspertimit mjeko-ligjor nr.17, datë 11.9.2009 i klinikës ligjore "Fisher Splitz", nuk përbëjnë provë të re në kuptim të nenit 450, shkronja "c" të K.Pr.Penale.

27. Gjyqtarët në procesin e dytë, në Dhomë Këshillimi kanë vlerësuar ekzistencën e shkaqeve për të rishikuar vendimin gjyqësor penal të formës së prerë, ndërsa në procesin parë, në seancë gjyqësore kanë vlerësuar respektimin ose zbatimin e drejtë të ligjit procedural dhe material. Gjyqtarët e pranishëm në Kolegjin Penal, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikim nuk kanë gjykuar drejtësinë e një vendimi të mëparshëm të dhënë prej tyre, por kanë vlerësuar ekzistencën e një prove të pretenduar si të re nga kërkuesi, e cila nuk dihej në kohën e gjykimit. Gjykata vlerëson se në këtë proces dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë në Dhomë Këshillimi kanë vlerësuar ekzistencën e një prej rasteve të parashikuara nga neni 450 i K.Pr.Penale. Duke qenë kështu, Gjykata konkludon se pretendimi për anësinë e gjyqtarëve është i pabazuar, sepse nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i justifikueshëm mbi anësinë e tyre.

28. Si përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit në lidhje me pretendimet e tij, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo, Petrit Ploçi, Vitore Tusha, Xhezair Zaganjori, Altina Xhoxhaj,

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi

### MENDIMI PAKICE

Nuk jemi dakord me arsyetimin e shumicës, sipas së cilës vendimi nr.615, datë 14.5.2010 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është në pajtim me nenin 42 të Kushtetutës.

Ne ndahemi me qëndrimin e shumicës për sa i përket pretendimit të kërkuarit për cenimin e parimit të paanshmërisë nga ana e gjyqtarëve që përbënin Dhomën e Këshillimit në shqyrtimin e kërkesës për rishikim.

Sipas kërkuarit, pjesëmarrja e dy gjyqtarëve në Kolegjin Penal (Dhomë Këshillimi) në shqyrtimin e kërkesës për rishikim dhe njëkohësisht edhe pjesëmarrja e tyre në Kolegjin Penal, ku kanë gjykuar çështjen me shqyrtimin me rekurs, ka cenuar parimin e paanshmërisë së gjykatës si element i procesit të rregullt ligjor.

Ne vlerësojmë se ky pretendim i kërkuarit qëndron dhe është i mbështetur mbi standardet jurisprudenciale të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) dhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Gjykata Kushtetuese e ka analizuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e standardit kushtetues të procesit të rregullt ligjor mbi aspektin e paanshmërisë.

Me vendimin nr.4, datë 25.2.2009, kjo Gjykatë është shprehur se “...parimi i paanshmërisë në gjykim edhe në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjyqimit, duke mos përjashtuar as shqyrtimin e çështjes në Dhomën e Këshillimit të Gjykatës së Lartë. Për Gjykatën është konsideruar “gjykatë e anshme” trupi gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë i pranishëm qoftë edhe vetëm një gjyqtar, i cili në këndvështrimin objektiv nuk jepte garanci për një gjykim të paanshëm...”

Rezulton se dy nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkuari dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit, që ka rrëzuar padinë e kërkuarit, kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit, të dhënë prej tyre. Gjykata vlerëson se, pavarësisht nga forma dhe referenca ligjore e paraqitjes së pretendimeve të kërkuarit në të dyja gjykimet, ato lidhen me shqyrtimin në fakt të së njëjtës çështje gjyqësore. Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të vlerësojë themelësinë e provës së re dhe rëndësinë e saj për çështjen, por vetëm të konkludojë nëse pjesëmarrja e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, në dy vendimet e dhëna për të njëjtën rrethanë të pretenduar (ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e tyre nga gjykimi), ka krijuar një dyshim të justifikuar te kërkuari se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm.”

Me vendimin nr.7, datë 7.3.2011, kjo Gjykatë është shprehur se: “.. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit

gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Dyshimi i mundshëm për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt”.

Në çështjen Driza kundër Shqipërisë, GJEDNJ-ja ka pohuar se: “... Gjykata vëren se, në përputhje me legjislacionin e brendshëm lidhur me rekursin në interes të ligjit, Gjykata e Lartë duhet të shqyrtonte çështjen me të gjithë anëtarët e saj. Tre prej gjyqtarëve, të cilët kishin dalë me një vendim për çështjen, ishin pjesë e Kolegjeve të Bashkuara, që do të vendosnin nëse do ta pranonin kërkesën për rekurs në interes të ligjit dhe rrjedhimisht për themelin e çështjes. Si pasojë, të tre gjyqtarët do të vendosnin nëse kishin gabuar në vendimin e tyre të mëparshëm apo jo. Për më tepër, tre gjyqtarë të tjerë të trupit gjykues duhet të vendosnin në lidhje me çështjen për të cilën ata e kishin dhënë njëherë sentencën e tyre. Në këto kushte, Gjykata konstaton se paanshmëria objektive e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lë shkas për dyshime. Kështu që dyshimi i ankuesit për këtë problem mund të konsiderohet mjaftueshëmrisht i bazuar” (vendim i datës 13.11.2007).

Në çështjen Driza bëhej fjalë për rekurs në interes të ligjit. Gjyqtarët që do të diskutonin nëse do të pranohej kërkesa, ishin të njëjtët që kishin dhënë vendim mbi themelin e çështjes. GJEDNJ-ja konkludoi se ka pasur shkelje të parimit të paanshmërisë, sepse dyshimi i ankuesit për këtë problem mund të konsiderohej mjaftueshëmrisht i bazuar.

Në vlerësojmë se pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në gjykim themeli, si dhe në procedurë pranimit ose jo të kërkesës pa i hyrë themelit, duhet provuar nëse ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm. Përfundimi lidhur me këtë varet prej rrethanave të çështjes.

Gjyqtarët në pakicë vërejnë se në çështjen konkrete, me vendimin nr.615, datë 14.5.2010, Kolegji Penal (Dhoma e Këshillimit) ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim me arsyetimin se deklaratat e tre shtetasve, sipas të cilëve kërkuesi Saimir Elmazi nuk është autor i vrasjes dhe akti ekspertimit mjeko-ligjor nr.17, datë 11.9.2009 i klinikës ligjore “Fisher Splitz”, nuk përbëjnë provë të re në kuptim të nenit 450, shkronja “c” të Kodit të Procedurës Penale. Po sipas Kolegjit Penal, edhe nëse do të pranohej akti i ekspertimit si provë e re, përmbajtja e këtij akti nuk tregon se vendimet e gjykatave janë të gabuara. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me këtë arsyetim, ka bërë vlerësimin e provës (aktekspertimit) dhe është shprehur se përmbajtja e saj nuk tregon se vendimet e gjykatave janë të gabuara, pra ka vlerësuar këtë provë të re në raport me provat e mëparshme.

Neni 450/c i Kodit të Procedurës Penale parashikon si një nga rastet e kërkesës për rishikim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar.

Shumica shprehet në vendimin e saj se gjyqtarët në shqyrtimin e kërkesës për rishikim nuk do të vlerësonin drejtësinë e vendimit të tyre të mëparshëm, por vlerën e një prove të re, dhe nuk kanë konsideruar përcaktimin ligjor se gjyqtarët në kërkesën për rishikim marrin në shqyrtim jo vetëm një provë të re, por edhe vlerësimin e saj së bashku me provat e mëparshme, për të cilat ata kanë dhënë një herë vlerësim.

Në rastin konkret, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me arsyetimin se, edhe sikur akt-ekspertimi të konsiderohej provë e re, përmbajtja e saj nuk tregon se vendimet e gjykatave janë të gabuara, ka vlerësuar drejtësinë e vendimit të mëparshëm të dhënë prej tyre. Ky Kolegj, me përbërjen e dy gjyqtarëve (BY dhe GD) në procesin e iniciuar në rekurs, nuk e ka lehtësuar pozitën e kërkuetit (u la në fuqi vendimi i apelit dhe dënimi i kërkuetit me 18 vjet burg), ndërkohë që në procesin e iniciuar me kërkesën për rishikim, Kolegji Penal (Dhoma e Këshillimit), me përbërjen e dy gjyqtarëve, nuk e ka pranuar kërkesën për rishikim, pra të dyja vendimet e dhëna nga kjo gjykatë kanë qenë kundër interesave të kërkuetit. Këta gjyqtarë kanë shqyrtuar rekursin e paraqitur nga kërkueti dhe kanë konkluduar për drejtësinë e vendimit të gjykatës së apelit, si dhe kanë shqyrtuar dhe kanë konkluduar edhe për mospranimin e kërkesës për rishikim të vendimit të dhënë prej tyre.

Ne vlerësojmë se ndërkohë që objektivisht kanë ekzistuar mundësitë për shmangien e dy gjyqtarëve nga gjykimi, ekzistenca e tyre ka krijuar një dyshim të justifikuar të kërkuesi, se vendimi i dhënë ka qenë produkt i një procesi të dyshuar si i njëanshëm.

Si përfundim, ne konkludojmë se pretendimi i kërkuesit për besueshmërinë e Gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme në perceptimin e publikut, është i drejtë. Për rrjedhojë, kërkesa duhej të ishte pranuar.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar) Sokol Sadushi, Admir Thanza, Sokol Berberi

**VENDIM**  
**Nr.26, datë 13.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Anëtar	i	Gjykatës	Kushtetuese,	drejtues	i	seancës	plenare
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“				
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“				
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“				
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“				
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e	“	“				
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“				

me sekretare Blerina Çinari, në datën 29.3.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.6 akti që i përket:

**KËRKUES:** Lulash Marku, përfaqësuar nga avokatët Arben Vasha dhe Astrit Prendi, me prokurë.

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, e përfaqësuar nga prokurori Kujtim Luli, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.00-2009-406 (681), datë 4.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr.254, datë 19.12.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër;

Shfuqizimi i vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër;

Interpretimi i nenit 146/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe i nenit 433/2 të Kodit të Procedurës Penale;

Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i togfjalëshit “nga mbrojtësit”, të nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 146/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 433/2 dhe 435/2 të Kodit të Procedurës Penale.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Sadushi; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.272, datë 19.7.2007 ka shpallur kërkuesin të pafajshëm kundrejt akuzës për kryerjen e veprës penale të “falsifikimit të dokumenteve shkollore”, të parashikuar nga neni 187 i Kodit Penal (KP). Me vendimin nr.254, datë 19.12.2007, Gjykata e Apelit Shkodër, pas ankimit të bërë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.272, datë 19.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër,

deklarimin fajtor të kërkuarit dhe dënimit me gjobë, si dhe heqjen e së drejtës për të ushtruar funksionin e mësuesit për një periudhë 5-vjeçare”.

2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i investuar me rekurs nga kërkuari, me vendimin nr.00-2009-406(681), datë 4.12.2009, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit” me arsyetimin se: “Rekursi i paraqitur nga i gjykuari Lulash Marku nuk është në formën e kërkuar nga ligji, pasi mungon nënshkrimi i mbrojtësit”. Gjykata e Lartë i është referuar neneve 420, pika 1, shkronja “c” dhe 435, pika 2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në dhënien e këtij vendimi.

3. Kërkuari i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (në vijim Gjykata), ku kërkon shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.00-2009-406 (681), datë 4.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimit nr.254, datë 19.12.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër; shfuqizimin e vendimeve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; interpretimin e nenit 146/2 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenit 433/2 të KPP-së; shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të togfjalëshit “nga mbrojtësit” të nenit 435/2 të KPP-së.

4. Kërkuari ka parashtruar përpara Gjykatës se:

4.1. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përmes të cilit rekursi i kërkuarit nuk është pranuar, është marrë në shkelje të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, për arsye se i ka mohuar të drejtën për t’iu drejtuar Gjykatës, nuk është arsyetuar dhe nuk është shpallur publikisht.

4.2. Vendimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër janë marrë në shkelje të neneve 328, 112/3, 128 të KPP-së dhe si të tilla janë të pavlefshme.

4.3. Moshpallja publike e vendimit gjyqësor, si dhe mospranimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve është në kundërshtim me kuptimin e nenit 146/2 të Kushtetutës dhe nenit 433/2 të KPP-së.

4.4. Togfjalëshi “nga mbrojtësit” në nenin 435/2 të KPP-së përbën një kufizim, i cili cenon thelbin e së drejtës për t’u ankuar dhe si i tillë duhet shfuqizuar si antikushtetues.

Gjatë shqyrtimit në seancë plenare, kërkuari i kufizoi pretendimet dhe në parashtrimet e tij u përqendrua vetëm në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke hequr dorë nga pretendimet e tjera.

5. Subjekti i interesuar, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, ka parashtruar me shkrim dhe në seancën plenare prapësimet e tij në këto drejtime kryesore:

5.1 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në Dhomë Këshillimi për mospranimin e rekursit nuk përbën proces të parregullt ligjor. Ky vendim përmban në thelb shkaqet e mosprimit dhe kjo formë arsyetimi është konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, si dhe është pranuar nga vetë jurisprudenca e Gjykatës;

5.2 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me të drejtë ka vlerësuar se rekursi nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji;

5.3 Mospranimi i rekursit në Dhomë Këshillimi nuk i ka mohuar kërkuarit të drejtën për t’u dëgjuar, për arsye se Dhoma e Këshillimit nuk e shqyrton çështjen në themel;

5.4 Kërkuari nuk legjitimohet për të kërkuar përpara Gjykatës shfuqizimin e dispozitës procedurale penale (nenit 435/2 të KPP-së), si të papajtueshme me Kushtetutën.

## II

A. Për pretendimin e mosarsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

6. Kërkuari ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit është i paarsyetuar. Gjykata Kushtetuese e ka përfshirë në jurisprudencën e saj arsyetimin e vendimeve gjyqësore si një element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në analizë të dispozitave kushtetuese dhe të dispozitave procedurale penale, Gjykata ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohen, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar dispozitat ligjore të zbatuara. “Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë... Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e

3600

lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve” (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 dhe vendimin nr.23, datë 23.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr.7, datë 9.3.2009, nr.23, datë 23.7.2009, nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka mbështetur vendimin në nenet 420/1(c) dhe 435/2 të KPP-së, të cilat parashikojnë mospranimin e rekursit kur nuk përmban nënshkrimin e mbrojtësit. Në vlerësimin e Gjykatës, nuk rezulton që vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Ky është një qëndrim, të cilin e ka evidentuar edhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ). Në çështjen Marini kundër Shqipërisë, të datës 18 dhjetor 2007, § 106, GJEDNJ-ja ka theksuar ndërmjet të tjerave se: “arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në Dhomë Këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, e cila është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se, kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*shih, mutatis mutandis, Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7 dhjetor 2010 § 51, dhe Nerva kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 11 korrik 2000*).

9. Nga sa më sipër, Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim, vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk cenon kërkesat që lidhen me arsyetimin e vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit në këtë aspekt është i pabazuar.

B. Për pretendimin e mosshpalljes publike të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

10. Mosshpalljen publike të vendimit gjyqësor nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, kërkuari e ka ngritur në funksion të pretendimit të tij për parregullsinë e procesit gjyqësor.

11. Sipas nenit 146, pika 2 të Kushtetutës: “Vendimet gjyqësore shpallen publikisht në çdo rast”. Jurisprudenca e GJEDNJ-së është e pasur me çështje, ku pretendohet shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), për arsye të mosshpalljes publike të vendimit të gjykatës. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së rezulton se kërkesa e shpalljes publike të vendimeve gjyqësore, është interpretuar në mënyrë elastike dhe jostrikte.

12. GJEDNJ-ja ka evidentuar në vijimësi qëndrimin e saj të konsoliduar se, forma e shpalljes publike të një vendimi, sipas ligjit të brendshëm kombëtar, duhet të vlerësohet në këndvështrimin e aspekteve të veçanta të çështjes konkrete dhe duke iu referuar objektit dhe qëllimit të nenit 6 § 1 (*shih Sutter kundër Zvicrës, 22 shkurt 1984, § 33; Pretto dhe të tjerë kundër Italisë, 8 dhjetor 1983, § 26; Szücs kundër Austrisë dhe Werner kundër Austrisë, 24 nëntor 1997*). Kështu në çështjen Sutter, GJEDNJ-ja ka çmuar se “kriteri i shpalljes publike sipas nenit 6 § 1 konsiderohej i përmbushur, nisur nga fakti se çdokujt që vërtetonte se kishte interes i mundësuar aksesit për të konsultuar tekstin e vendimit ose marrja e një kopjeje të plotë të vendimit të Gjykatës Ushtarake të Kasacionit, shoqëruar me faktin se vendimet e kësaj Gjykate ishin të publikuara në një përmbledhje zyrtare” (*ibid.*, § 34). Duke pasur parasysh natyrën e çështjes dhe formën e shpalljes publike që aplikohet nga sistemi ligjor i brendshëm kombëtar, GJEDNJ-ja vlerëson se një interpretim tekstual i



formulimit të nenit 6 § 1, në pjesën që ka të bëjë me shpalljen e vendimeve, jo vetëm do të ishte i panevojshëm, por do të dëmtonte qëllimin e nenit 6 § 1, që është garantimi i një procesi të drejtë ligjor (*shih, mutatis mutandis, Sutter, supra, § 34*). Në çështjen Axen kundër Gjermanisë, datë 8 dhjetor 1983, § 32, shpallja publike e vendimit të Gjykatës së Lartë u konsiderua si e panevojshme, duke qenë se kërkesat e nenit 6 plotësoheshin nga shpallja publike e vendimeve të gjykatave më të ulëta. Gjithashtu, edhe në raste të tjera të shqyrtuara, ku vendimet e gjykatave të larta nuk janë shpallur publikisht, GJEDNJ-ja, duke pasur parasysh edhe praktikën e ndjekur në shumë shtete të Këshillit të Europës, ka theksuar se kriteri i shpalljes publike të vendimeve konsiderohet i përmbushur kur teksti i plotë i vendimit, i depozituar në sekretarinë e Gjykatës, është i disponueshëm për këdo (*shih Pretto dhe të tjerët, supra, § 26*).

13. Në kuptim të nenit 146/2 të Kushtetutës dhe në referencë të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se, në rastin në shqyrtim, shpallja publike e vendimit gjyqësor, i marrë në Dhomën e Këshillimit dhe pa pjesëmarrjen e palëve, vlerësohet si një detyrim i përmbushur për Gjykatën e Lartë. Përderisa nuk është penguar e drejta e kërkuarit për t'u konsultuar me përmbajtjen e plotë të vendimit, nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të saj, ose me çdo mënyrë tjetër nga sekretaria e gjykatës, pretendimi i tij për mosshpallje publike të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

C. Për pretendimin për cenimin e të drejtës për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (e drejta e aksesit)

14. Kërkuarisi ka pretenduar se mospranimi i rekursit nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsye të mungesës së nënshkrimit të mbrojtësit, i ka mohuar atij të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë përgjigje mbi shkaqet e ngritura në rekurs.

15. Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuarit në kuptim të standardeve që përkufizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një e drejtë themelore e njeriut dhe një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Sanksionimi i kësaj të drejte i jep mundësinë individit t'i drejtohet një organi të paanshëm, të caktuar me ligj, me qëllim vendosjen në vend të një të drejte të cenuar. Neni 31, shkronja "ç" i Kushtetutës parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme. Nga ana tjetër, neni 43 i Kushtetutës parashikon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë, prandaj, çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së, nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009*).

16. Në këtë këndvështrim, e drejta e individit për t'iu drejtuar gjykatës nuk përfshin vetëm të drejtën për të hapur një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009*).

17. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, mospranimi i një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenojë thelbin e të drejtës së ankimesit për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997, Saez Maeso kundër Spanjës, datë 9.11.2004*). Edhe në çështjen Xheraj kundër Shqipërisë, të datës 29 korrik 2008, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kjo e drejtë është thelbësore në një shoqëri demokratike, për shkak të pasojave që ka mbi interesat legjitimë të individit.

18. E drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por kufizimet nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e së drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010*). Në këtë kuptim, Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit

procedural, të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në KPP, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7.2006*).

19. Gjykata vlerëson se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon, *inter alia*, se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimi, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Qëllimi i këtij neni është të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs. Standardi i mbrojtjes me avokat në Gjykatën e Lartë nuk garantohet plotësisht nëse respektohet vetëm gjatë shqyrtimit gjyqësor. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrihen shkaqet, për të cilat kundërshtohet një vendim sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së, që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, e cila njihet edhe si “procesi i avokatit”, është në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale.

20. Për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinonë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së) dhe paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale, që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së. Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr.38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi Lulash Marku ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një recur, i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së.

22. Gjykata çmon se, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalia vijuese e këtij neni procedural. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese dhe debati gjatë seancës gjyqësore, nuk rezulton që sekretaria gjyqësore të ketë përmbushur detyrimin për vënien në dijeni të kërkuesit për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit të rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ai të mund të bënte plotësimet e nevojshme.

23. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë.

D. Për antikushtetueshmërinë e togfjalëshit “nga mbrojtësit” të nenit 435/2-të KPP-së

24. Cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, kërkuesi e ka arsyetuar edhe në funksion të antikushtetutshmërisë që përmban fraza “nga mbrojtësit”, e cila parashikohet në nenin 435/2 të KPP-së.

25. Mbrojtja me avokat e të pandehurit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, bazuar në nenin 437, pikat 3 dhe 5 të KPP-së, është vlerësuar nga Gjykata si kërkesë e nevojshme

në funksion të garantimit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale, që është në interes të drejtësisë. Në këtë vështrim, Gjykata vlerëson se edhe neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon se rekursi dhe memoriet që i drejtohen Gjykatës së Lartë duhen të nënshkruhen nga mbrojtësit e të pandehurve, ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin kur ai ushtron rekurs.

26. Në situatën konkrete, në të cilën kërkuesi ka paraqitur rekurs të panëshkruar nga mbrojtësi, Gjykata vlerëson se interpretimi pajtues që i ka bërë nenit 435/2 të KPP-së, është në favor të garancive të kërkuesit për të mos e humbur të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Nga kjo pikëpamje, Gjykata thekson se kërkuesit, si një subjekt me legjitimitet të kushtëzuar, në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, për rastin në shqyrtim, i mungon interesi për të kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të dispozitës procedurale.

27. Përfundimisht, Gjykata arrin në konkluzionin se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuesit Lulash Marku i është cenuar e drejta e aksesit, si një element thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

#### PËR KËTË ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.00-2009-406 (681), datë 4.12.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Sokol Sadushi

#### MENDIM PARALEL

Ndonëse jam në një mendje me shumicën lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes me kërkues Lulash Marku, nuk bie dakord me të për bazën juridike kushtetuese ku e mbështet vendimin për pranimin e kërkesës.

Sipas arsytimit të shumicës, kërkuesit i është cenuar e drejta e aksesit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, si një element thelbësor i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Mendoj se në rastin në fjalë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke mos pranuar rekursin e paraqitur nga kërkuesi me arsytimin se i mungon nënshkrimi i mbrojtësit, nuk i ka mundur atij të realizojë efektivisht një të drejtë themelore kushtetuese, të drejtën për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës.

E drejta e aksesit dhe e drejta për t'u ankuar kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, standarde këto të mbrojtura respektivisht nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës janë dy çështje me natyrë kushtetuese, në thelb të ndryshme dhe me dallime të qarta nga njëra-tjetra.

Këto dy çështje, mendoj se ende nuk janë përpunuar si duhet në jurisprudencën e kësaj Gjykate, gjë që vërehet edhe në arsytimin e shumicës në çështjen konkrete. Si në titull (*shih shkronjën C të vendimit*), ashtu dhe në pikat 15 dhe 16 vërehet një konfuzion lidhur me këto çështje kur shumica, të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë e trajton edhe si të drejtë aksesi, ashtu dhe si të drejtë ankimi (pika 15). Ndërsa në pikën 16, duke iu referuar një vendimi të kësaj Gjykate (*vendimi nr.14, datë 3.6.2009*), shumica kundërshton qëndrimin e vet kur përpiqet të japë kuptimin kushtetues të së drejtës të aksesit. Në këtë vendim, në përputhje dhe me qëndrimin konstant të 3604

mbajtur nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, thuhet se aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv, dhe jo thjesht formal, që do të thotë se kjo e drejtë përfshin si të drejtën për të hapur një proces, ashtu dhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare nga gjykata në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

Sipas legjislacionit procedural shqiptar janë vendime përfundimtare, vendimet e gjykatave të rretheve gjyqësore të shkallës së parë, në qoftë se nuk janë ankimuar brenda afatit të ankimit, si dhe vendimet e gjykatës së apelit, të cilat janë të formës së prerë. Ndaj tyre organet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore kanë detyrimin për t'i venë menjëherë në zbatim.

Duke iu referuar çështjes objekt gjykimi, kërkuesi ka pasur akses të plotë në gjykatë në kuptimin kushtetues. Ai jo vetëm ka realizuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje përfundimtare përderisa ankimi i tij jo vetëm është shqyrtuar dhe konsideruar nga gjykata e apelit, por kjo e fundit ka dalë dhe me një vendim përfundimtar, i cili është i formës së prerë. Nga kjo pikëpamje, mendoj se nuk mund të shtrohet për diskutim cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e cila parashikon standardet minimale për mbrojtjen e këtyre të drejtave nga shtetet palë në të.

Çështja që i përket kërkuesit jo vetëm është dëgjuar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në rastin konkret Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës, por vendimi i marrë prej saj është ankimuar nga kërkuesi në Gjykatën e Apelit të Shkodrës, e cila pasi ka pranuar ankimin, ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë një vendim përfundimtar të formës së prerë. Me marrjen e këtij vendimi kërkuesi ka realizuar tërësisht të drejtën e aksesit dhe, për rrjedhojë, procesi i zhvilluar ndaj tij ka qenë plotësisht i rregullt edhe në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

Kushtetutëbërësi shqiptar, duke sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës të drejtën e ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë ka parashikuar një standard më të lartë të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në raport me ato të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së. Mosrealizimi i kësaj të drejte nga cilido shtetas shqiptar nuk do të thotë aspak se atij i është mohuar e drejta për akses për sa kohë që ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor dhe është marrë një vendim nga një gjykatë e pavarur e krijuar me ligj dhe, për më tepër, ky vendim ka marrë formë të prerë në apel, gjë që e bën atë përfundimtar. Në këto raste mund të flitet vetëm për mohim të së drejtës të ankimit kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, në rastin konkret, kundër vendimit të gjykatës së apelit në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, gjë që bie ndesh me nenin 43 të Kushtetutës.

Duke arsyetuar më tej, mendoj se ky qëndrim duhet mbajtur sa herë që shtrohet problemi i mospranimit për shqyrtim të rekurseve nga ana e kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë. Ndryshe qëndron çështja me mohimin e së drejtës për rishikim të vendimeve të formës së prerë. Sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale, e drejta për të kërkuar në Gjykatën e Lartë rishikimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë lidhet kryesisht me rrethana të reja të zbuluara rishtas, të cilat po të diheshin në momentin e shqyrtimit të çështjes nga gjykatat respektive mund të ndryshonin themelin e vendimit për shkak të deformimit të thelbit të së drejtës. Në këto raste kemi të bëjmë me një situatë krejt tjetër edhe në kuptimin kushtetues. Mendoj se çdo mospranim i pabazuar i kërkesave të tilla nga kolegjet përkatëse të Gjykatës së Lartë i mohon shtetasve të drejtën e aksesit, që do të thotë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të kërkuar shqyrtimin rishtazi të çështjes në të gjitha nivelet e gjykimit. Në këto raste mund të flitet pa hezitim për një proces të parregullt në kuptimin kushtetues dhe që, për rrjedhojë, vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

Anëtar: Vladimir Kristo

**VENDIM**  
**Nr.27, datë 14.6.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Piloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtar	e	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datat 27.4.2011 dhe 10.5.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.15 Akti që i përket:

**KËRKUES:** Kujtim Qefalia, përfaqësuar nga avokatja Elira Kokona, me prokurë

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Marsida Xhaferllari, me autorizim

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, i vendimit nr.138, datë 1.3.2011 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dajt”;

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Këshillit të Ministrave.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 5, 17, 42, 45, 109, 115, 122, 131/a të Kushtetutës; nenet 45, 49, 50 dhe 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 42 i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”,

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi kërkuesin që në kërkesat paraprake hoqi dorë nga gjykimi i kërkesës dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes; përfaqësuesin e subjektit të interesuar Këshilli i Ministrave që kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes,

**VËREN:**

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.138, datë 1.3.2011, ka vendosur shkarkimin nga detyra, për shkelje të rënda ligjore, të kryetarit të komunës Dajt, Kujtim Qefalia.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 15.3.2011 me kërkesë për shfuqizimin dhe pezullimin e vendimit të mësipërm të Këshillit të Ministrave (VKM) si në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

- VKM-ja për shkarkimin është marrë në mungesë të një procedure transparente dhe bazohet në një ligj të paqartë. Neni 42/a i ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, që është baza ligjore e shkarkimit, e zgjeron fushën e parashikimeve të nenit 115 të Kushtetutës, duke përfshirë përveç shkeljeve të Kushtetutës dhe ligjit penal edhe “çdo shkelje të rëndë të ligjit të çdo lloj natyre”. Kjo krijon premisa për parregullsi në vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave dhe arbitraritet të arsyeve të shkarkimit të organeve të qeverisjes vendore.

- Vendimi i shkarkimit është i paarsyetuar, pasi nuk jep asnjë arsye për shkaqet konkrete që çuan në shkarkimin e kryetarit të komunës Dajt.

- Shkeljet e prezumuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nuk përbëjnë “shkelje të rënda të ligjit”, pasi veprimet juridike të kallëzuara penalisht jo vetëm nuk kanë sjellë pasoja me karakter

penal ndaj kërkuesit, por ato nuk krijojnë asnjë pasojë juridike në kushtet e parashikimeve përkatëse të Kodit Civil.

- Proporcionaliteti i masës së shkarkimit nga detyra të një të zgjedhuri vendor është në kundërshtim me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

Në seancën plenare të zhvilluar në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata) në datën 10.5.2011 përfaqësuesja ligjore e kërkuesit, në prani dhe të këtij të fundit, paraqiti kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga gjykimi dhe për pushimin e çështjes objekt shqyrtimi.

Subjekti i interesuar u shpreh dakord me kërkesën dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes.

Gjykata konstaton se ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 1, paragrafi i dytë, parashikon se “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”. Bazuar në këtë normë, Gjykata iu referua nenit 201 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i cili parashikon se “Paditësi në çdo fazë të gjykimit mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Në këtë rast, gjykata vendos pushimin e gjykimit”.

Në kushtet e mësipërme, Gjykata vlerëson se plotësohen kriteret për pushimin e gjykimit të çështjes në bazë të dispozitës së sipërcituar të KPC-së.

#### PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 1 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenin 201 të KPC-së, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Sokol Sadushi, Petrit Pllloçi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 21.6.2011  
Doli nga shtypi më 23.6.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 32 lekë